



Republika e Kosovës – Republika Kosova  
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia  
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

ZL Anr.295/2017

**Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP)**, në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Gyltene Sylejmani kryesuese, Ymer Hoxha dhe Adnan Konushevcu anëtarë, si dhe me pjesmarrjen e zyrtarit ligjor Ardian Maxhuni, duke vendosur përkitazi me ankesën e subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV) me seli në Prishtinë, paraqitur kundër subjektit politik Nisma për Kosovën (NISMA), me seli në Malishevë, dega në Malishevë, për shkak të thyerjes së heshtjes zgjedhore, për Zgjedhjet Lokale të datës 22.10.2017, në seancën e panelit të mbajtur me datë 23.10.2017, mori këtë:

## V E N D I M

**Pranohet** si e bazuar ankesa e Lëvizjes Vetëvendosje (LVV), ashtu që subjektit politik Nisma për Kosovën (NISMA), i shqiptohet dënimi më gjorbë në shumë prej 3500 (tremijë e pesëqind) euro, të cilën detyrohet ta paguaj në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga dita e pranimit të këtij vendimi **nën kërcënim të përmbarimit**.

## A r s y e t i m

Me datën 21.10.2017, PZAP-i ka pranuar një ankesë nga subejkti politik LVV me të cilën pretendon se aktivisët tonë me datën 20.10.2017, rreth orës 18:00 kanë verifikuar në shtypin ditor “Zëri” një video në të cilën kryetari i subjektit politik Nisma, me rastin e mbajtjes së fjalimit në mes tjerash thekson se “tash është ajo që e kemi fole gjatë fushatës, koha për punësime”. Më tutje citohet të ketë thënë “ne kemi filluar atje ku duhet dhe ju do ti shihni rezultatet e para, duke vazhduar se shumë shpej disa prej rezultateve do ti shihni javën tjetër , nëpër fshatrat tuaja e disa nga njerëzit do të pñesohen”. Për më tepër theksohet se të njëjtit pra kryetari nga subjekti politik Nisma me rastin e fjalimit i konfirmohet se është duke u xhiruar dhe ka kërkuar që të ndalen kamerat në mënyrë që të ndërprehet transmetimi, duke theksuar “ a ban me ndale veç pak, a e keni marrë Ragipin dhe në rregull jemi bajm llaf kështu pa kamera, pa havale”.

Parashtruesi i ankesës thekson se këto veprime bien ndesh me nenin 35 paragrafi 2 lidhur me nenin 33 paragraf 1 pika f) e LZP-së .

Parashtruesi i ankesës si provë ka bashkangjitur 2 video inqizuese në cilësi të provës materiale.

Në përgjigje në ankesë subjekti politik PDK thekson se ky tubim është mbajtur me datë 12.10.2017, në ora 20:00 – 21:00, në restorantin “BMI2” në Malishevë, me rastin e takimit me rinin e Malishevës. Më tutje thekson se këto veprime nuk kanë të bëjnë me shkelje të legjislacionit dhe rregullave zgjedhore, sepse nuk kemi të bëjmë në asnjë moment me shfrytëzimin e aseteve zyrtare e as të pozitës publike, pasi që kryetari nga radhët e subjektit politik NISMA ka mbajtur fjalsim në cilësi të kryetarit të partisë, por jo në cilësi të pozitës publike që e ushtron aktualisht në Qeverinë e Republikës së Kosovës.

Në mes tjerash ka shtuar, duke e interpretuar nenin 33 paragraf 1 pika f) se në asnjë moment nga kohëzgjatja e fjalit të kryetarit të subjektit politik NISMA, nuk kemi të bëjmë me premtime që do të pasonin me shpërblime financiare në këmbim të votës, ashtu siq potencon nga ankesa ankuesi.

Më tutje thekson se, pretendimet ankimore janë të pa bazuara, sepse në asnjë rrethanë dhe me asnjë provë kryetari ynë nuk e ka keqpërdorur pozitën publike dhe se në fjalimin e tij ai ka sqaruar projektet strategjike në vend dhe programin e subjektit politik NISMA . PZAP-it i ka kërkuar që ankesën ta refuzoj si të pa bazë.

Paneli, pasi që shqyrtoj ankesën dhe provat që gjenden në shkresat e lëndës në kuptim të nenit 117 të LZP-së gjeti se:

#### **Ankesa është e bazuar**

Nga shkresat e lëndës, në video- inqizimin e administruar si provë Paneli ka vërtetuar se kryetari nga radhët e subjektit politik Nisma për Kosovën në Malishevë, në një restorant në Malishevë me rastin e një takimi me të rinjtë ka mbajtur fjalim gjatë heshtjes zgjedhore, prej datës 21.10.2017 ora 00:00 pra i njeiti ka zhvilluar fushatë zgjedhore dhe nga përmbatja e fjalimit të mbajtur vërtetohet qartë se me datën 21.10.2017, në minutën e 00:46 dëgjohet duke thënë “dhe tash është ajo çfarë kemi fol gjatë fushatës”, më tutje citohet të ketë thënë “ne kemi filluar atje ku duhet dhe ju do ti shihni rezultatet e para, duke vazhduar se shumë shpej disa prej rezultateve do ti shihni javën tjetër , nëpër fshatrat tuaja e disa nga njerëzit do të pënsohen duke i kujtuar premtimet e bëra të fushatës zgjedhore. Po ashtu Paneli, nga video inqizimi ka vërejtur se në minutën 01:35, gjatë fjalimit kryetari në fjalë ka kërkuar që fjalimi të ndalet dhe të bisedojnë pa prezencën e kamerave. Prandaj subjekti politik Nisma për Kosovën me këto veprime ka shkelur Kodin e Mirësjelljes për Subjektet Politike, Mbështetësit dhe Kandidatet e tyre duke bërë thyerjen e heshtjes zgjedhore.

Andaj Paneli duke marr parasysh këtë si dhe në mbështetje të dispozitave ligjore të LZP-së konstaton se subjekti politik NISMA për Kosovën është përgjegjëse për veprimet e saja për shkak të thyerjes së heshtjes zgjedhore, veprime këto që janë të sanksionuara me nenin 36 paragrafi 1 pika b) e LZP-së, ku parashihet se: 24 orë para hapjes së Qendrave të Votimit për hedhjen e votës, deri në mbylljen e tyre, subjekteve politike, mbështetësve ose kandidatëve të tyre u ndalohet bërja e fushatës në çfarëdo mënyre.

Paneli në kuptim të nenit 120.1 pika c) dhe nenit 118.1 të LZP-së, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

**Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia**  
ZL Anr.295/2017 më datën 23.10.2017.



**Kryesuesi i Panelit**  
**Gyltëne Sylejmani**

**Këshillë juridike:** *Kundër këtij vendimi nuk lejohet ankesa konform nenit 118.4 të LZP-së.*